



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1119/6 prot.

Tiranë, më 06.07.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1119/1, DATË 17.07.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR, TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. APOSTOL KOSTA"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e Z. Apostol Kosta, me nr. 1703 prot, datë 24.07.2020 dhe nr. 1703/2 prot datë 31.12.2020, ndaj veprimtarisë së magjistratit A.D, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër dhe magistrates M.I, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë, Sarandë dhe me vendimin nr. 1119/1 datë 17.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi Apostol Kosta", bazuar në nenet 120, pika 1, shkronja, "d" dhe "dh", nenin 121, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqënëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas adresës së lënë nga ankuesi; I.E.V.P, Bënçë, Tepelenë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

